REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY
Dep. 2-D/DPK
Nr. Prot 01-4956/14
Nr. faq. 02
Data 23-12-2014

# Republika e Kosovës

## Republika Kosova - Republic of Kosova

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**
**ANTI – CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1.1), nenin 5 (paragrafi 1.5) dhe nenin 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 19 (paragrafi 11) të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit (nr.01/2014), Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 22.12.2014, nxjerr këtë:

### V E N D I M

**I. Mbyllet rasti** me Nr. AKK-03-3975-14 për z.***Aleksandar Markoviç*** – Drejtor i Drejtorisë për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport në Zyren Administrative të Mitrovicës Veriore, për shkak se është shmangur dhe parandaluar situata e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

**II.** Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

### A r s y e t i m

**I.** Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-3975-14, për Zyrtarin e lartë, z.Aleksandar Markoviç–Drejtor i Drejtorisë për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport në Zyren Administrative të Mitrovicës Veriore dhe njëkohësisht person i autorizuar në një ndërrmarrje private, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Zyrtari i lartë, z.Markoviç fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit (Z.D./DPK-01-4236-14), pas të cilës ai është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë kundër Korrupsionit, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur dhe për të parandaluar kështu situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z.Markoviç është deklaruar se shumë shpejt do t'i bëjë ndryshimet e nevojshme.

Ndërkohë, z.Markoviç, në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka sjellë një shkresë përcjellese (DPK/DPKI-03-4916/14) së bashku me "Informata mbi biznesin" nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) në të cilën shihet se ai ka hequr dorë nga funksioni i të qenurit person i autorizuar i biznesit P.P."NG PROMET" .

Tani, z.Markoviç, ushtron vetëm funksionin e tij publik; Drejtor i Drejtorisë për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport në Zyren Administrative të Mitrovicës Veriore

**II.** Në mbështetje të nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
Hasan Preteni

______________________

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY

U skladu sa članom 11(stav1.1), člana 5 (stav 1 tačka 1.5), člana 18(stav10 i 11) Zakona br.03/L-159 za Agenciju protiv Korupcije kao i člana 19 (stav 11) Pravilnika br. 01/2014 o Radu Agencije protiv Korupcije, Direktor Agencije protiv Korupcije je dana 22.12.2014 doneo :

## R E Š E NJ E

**I, Zatvara se slučaj** Br. AKK-03-3975-14 za ***g.Aleksandar Markovića*** – Direktora Obrazovanja,Kulture, Omladine i Sporta u Administrativnoj Kancelariji Severne Mitrovice, iz razloga što je izbegnuta i sprečena situacija sukoba interesa u vršenju javne funkcije..

**II** Slučaj se može obnovit u svako doba ukoliko se jave nove okolnosti.

## Obrazloženje

**I.** Slučaj je otvoren pod osnovanom sumnjom **za Sukob Interesa u vršenju javne funkcije,** pod br.AKK-03-3975-14 za Visokog zvaničnika G.Aleksandra Markovića-Direktora Obrazovanja,Kulture, Omladine i Sporta u Administrativnoj Kancelariji Severne Mitrovice i istovremeno ovlašćeno lice u jednom privatnom biznesu, tretiran je u zakonom predviđenoj proceduri, za sprečavanje sukoba interesa u vršenju javne funkcije(Zakon br. 04/L-051).

Visoki zvaničnik , g.Marković je prvo preko službenog pisma obavešten od strane Agencije protiv Korupcije(Z.D./DPK-01-4236-14), nakon čega se pojavio na sastanku sa zvaničnicima Agencije protiv Korupcije,i tom prilikom je upoznat sa situacijom u kojoj se nalazi, kao i sa izmenama koje treba da izvrši, da bi se izbeglo i sprečilo stanje sukoba interesa u vršenju njegove javne funkcije.

Visoki zvaničnik, g.Marković je izjavio da će vrlo brzo izvršiti neophodne izmene.

U međuvremenu, g.Marković je Agenciji dostavio prateće pismo (DPK/DPKI-03-4916/14) zajedno sa "informacijom o biznisu" od strane Agencije za Registraciju Biznisa na Kosovu

(ARBK), na kojem se vidi da se on odrekao funkcije ovlašćenog lica u biznisu P.P."NG PROMET".

Sada, g.Marković obavlja samo njegovu javnu funkciju-Direktora Obrazovanja,Kulture, Omladine i Sporta u Administrativnoj Kancelariji Severne Mitrovice

**II.** Uskladu sa članom 18 (stav 11) Zakona br.03/L-159 za Agenciju protiv Korupcije, Agencija može obnoviti slučaj u svako doba ukoliko se pojave nove okolnosti.

Stoga je odlučeno kao u dispozitivu ove odluke

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
Hasan Preteni

______________________